



VENDIM

Nr. 143, Datë 26.11.2015

**PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “C & S ENERGY” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “d”; 39 pika 4 dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5, pika 2; 13 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “C & S Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie;

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të liçensës (neni 9, pika 4./10, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), rezulton se vërtetimi nga tatim – taksat është në proces apelimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 30 – vjeçar, me kusht që të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim – taksave.
2. Me plotësimin e afatit 45 ditor të sipërcituar, ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI